



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 103, datë 30.07.2019

PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. ELSA TOSKA NË VENDIN VAKANT PËR
GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA PRESIDENTI I
REPUBLIKËS NË DATËN 04.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar/Relator
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- **znj. Mimoza Arbi**, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës **17.07.2019, 24.07.2019 dhe 30.07.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATE PËR GJYQTARE
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

Znj. Elsa Toska

OBJEKTI:

Urdhërimi i lejimit të kandidimit të znj. Elsa Toska, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **z. Fatri Islamaj**,

mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtares Altina Xhoxhaj.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe znj. Elsa Toska.

4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtari i Këshillit, z. Fatri Islamaj.

7. Znj. Elsa Toska, si njëra ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Elsa Toska, gjendet e administruar në dosjes e kandidatës.

8. Në datën 09.04.2019, kandidatja Elsa Toska është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidates të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidates.
9. Në datën 15.04.2019, kandidatja Elsa Toska ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidates.
10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr.265 prot., datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.
11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Elsa Toska, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.
12. Me shkresën nr.2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Elsa Toska e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.
13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr.6/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Elsa Toska dhe personat e lidhur me të.
14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 4 të nenit 229 dhe nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Elsa Toska dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatës Elsa Toska, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidatës), si më poshtë:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekteve financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Elsa Toska.

17. Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, në datën 28.05.2019, Këshilli ka njoftuar në rrugë elektronike kandidaten Elsa Toska për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si edhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ajo disponon.

18. Kandidatja Elsa Toska, në datë 29.05.2019, në rrugë elektronike, ka dhënë shpjegimet përkatëse duke bashkëlidhur edhe dokumentacion shtesë justifikues.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr.110 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015 nga kandidatja Elsa Toska.

20. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1134/209 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Elsa Toska.

21. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatës Elsa Toska, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr.120 prot., datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr.114 prot., datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr.118 prot., datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr.117 prot., datë 17.04.2019*).

22. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjzbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

23. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat *nr.1545 prot., datë 10.06.2019* dhe *nr.680/1 prot., datë 15.05.2019*, mbi të dhënat e kërkuara për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe kandidaten Elsa Toska.

24. Në vijim të procedurave të verifikimit dhe kontrollit të integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 112 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nr. 45/2015 nga kandidatja Elsa Toska për kompetencë dhe shqyrtim pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

25. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.551/1 prot., datë 03.05.2019 ka dërguar vendimin nr.271 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Elsa Toska.

26. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Elsa Toska në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

27. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për

Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Elsa Toska.

28. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, lidhur me kushtin e parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*, me shkresën nr.268 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Gjykatës Kushtetuese, pranë të cilit kandidatja Elsa Toska ka ushtruar dhe vijon ushtrimin e funksioneve publike, për të dërguar të dhëna nëse ka pasur dhe ka masa disiplinore ndaj kësaj candidateje.

29. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr.144/1 prot., datë 23.04.2019.

30. Së fundi, në lidhje me kandidaten Elsa Toska, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 105 datë 12.02.2019 ka vendosur konfirmimin e saj në detyrë, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datës 21.03.2019.

31. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75, 87 dhe 94 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtari relator i Këshillit z. Fatri Islamaj ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

32. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të znj.Elsa Toska, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

33. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatës Elsa Toska.

34. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

35. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

36. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

37. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatës Elsa Toska.

38. Në thelb, Avokati i Popullit parashtroi se ka mungesë dokumentacioni në dosjen e dërguar pranë këtij Institucioni që vërteton plotësimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore, mbi bazën e të cilave mund të jepen konkluzione paraprake për procedurën e ndjekur. Duhet të sqarohet plotësimi i kriterit të përvojës referuar pozicionit të juristit të nivelit të lartë në administratën publike. Nga dokumentacioni i ndodhur pranë institucionit tonë rezulton se kandidatja ka filluar punë me kontratë njëvjeçare pune në datën 01.09.2000 dhe më pas nuk ka dokumentacion si e ka fituar statusin e nëpunësit civil.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

39. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatës, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin kandidimit të kandidatës Elsa Toska për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

40. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriterë të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

41. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

42. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr.6/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Elsa Toska dhe personat e lidhur me të.

43. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Elsa Toska, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor.
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
- ç) Nuk ka kryer deklarin të rremë.
- d) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

44. Përfundimet e sipërcituara të ILDKPKI, bazohen në gjetjet vijuese të raportit të kontrollit:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara në Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për institucionet e sistemit të drejtësisë, si pedagogje e jashtme për periudhën 2017 - 2018, në Universitetin Polis, Luarasi, Justicia, Ilyria dhe Universiteti Mesdhetar.
- Gjithashtu evidentohet se në deklaratat e interesave private Periodike Vjetore 2017 dhe 2018, subjekti ka deklaruar të ardhura vetëm nga Universiteti Polis dhe Mesdhetar.
- Janë të paqarta transaksionet e konfirmuara nga DPPPP në shumën rreth 9.770 euro, si dhe mungon dokumentacioni justifikues lidhur me përfitimin e tyre.

45. Në zbatim të pikës 26 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, nisur nga gjetjet e sipërcituara, në datën 28.05.2019, Këshilli ka njoftuar në rrugë elektronike kandidaten Elsa Toska për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si edhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ajo disponon në lidhje me shpjegimet e saj.

46. Kandidatja Elsa Toska, në datë 29.05.2019, në rrugë elektronike, ka dhënë shpjegimet përkatëse dhe ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, nëpërmjet të cilit, në thelb, parashtron se:

- Në parim, vlerësoj se "Formulari për deklarimin e pasurisë dhe interesave të kandidatit për institucionet e sistemit të drejtësisë", nuk duhej plotësuar nga unë si subjekt kontrolli për shkak të faktit se jam edhe subjekt deklarimi periodik që nga viti 2003, edhe kam qenë subjekt rivlerësimi kalimtar. Për rrjedhje iu nënshtrova kontrollit të plotë dhe të thelluar të pasurisë për gjithë jetën time, si për veten dhe për personin e lidhur, bashkëshortin tim.
- Pas plotësimit dhe dorëzimit të këtij formulari pranë ILDKPKI, përgjigja e këtij institucioni për këtë rast duhet të kishte qenë se: *"Bazuar në nenin 3/1, prg.2, të ligjit nr.9049/20003, me ndryshimet përkatëse, ky subjekt është brenda afatit 160 ditë nga kontrolli me sukses i pasurisë nga një institucion kushtetues si KPK, institucion me ekspertizë më të lartë dhe kontroll më të thelluar se sa ILDKPI, prandaj dhe nuk duhet kontrolluar, pasi vendimi i KPK nr.105/2015, që mori formë të prerë në 21.03.2019, duhet të konsiderohet kontroll me sukses sipas ligjit"*.
- Për Formularin "Për deklarimin e pasurisë dhe interesave të kandidatit për institucionet e sistemit të drejtësisë", duke qenë se e kisha plotësuar një herë për llogari të procesit të rivlerësimit kalimtar, u zgjodh plotësimi sipas një metodologjie, ku deklarohej nga e para çdo të ardhur dhe pasuri gjatë jetës profesionale deri në deklaratën e vetingut, plus duke shtuar të ardhurat apo pasuritë e vëna për vitet 2017, dhe 2018 dhe deri në prill 2019.
- Konkretisht, për universitetet Justicia, Ilyria dhe Luarasi, nuk është shkruar *"shih DPV 2017 dhe DPV 2018"*, siç ka interpretuar ILDKPI, por është shkruar: *"shih formularin e vetingut, DPV ndër vite"*. Pra *"DPV ndër vite"*, që do të thotë për vitet që kam dhënë mësim, jo DPV 2017 dhe 2018. Ndërkohë, është theksuar qartësisht për vitet 2017 dhe 2018 deklarim vetëm për Universitetin Polis dhe Mesdhetar. Po kjo metodologji është ndjekur dhe për Albanian University ku ka pasur mësimdhënie vetëm një semestër në vitin 2008, dhe përsëri është shkruar *"shih formularin e vetingut, DPV ndër vite"*. Kështu që konstatimi i ILDKPI se nuk janë bërë deklarime për këto universitete për vitet 2017 dhe 2018, nuk qëndron as në interpretimin sistematik, as në atë historik. Për më tepër nuk qëndron as nga pikpamja teleologjike, pasi nga deklarimi, ky institucion duhet të kishte konstatuar se për angazhimet në këto universitete shifra në lekë, e deklaruar në Formularin e kandidimit është e njëjta si në Formularin e vetingut, pra duhet ta kishte lexuar si 0 lekë në këto tre universitete për të ardhurat e mia 2017 dhe 2018, dhe 0 efekte financiare në pasurinë time për 2017 dhe 2018 nga këto universitete. Kështu që, bie dhe detyrimi për dokumentacion justifikues, pasi nuk ka pasur të ardhura nga këto universitete për 2017 dhe 2018. Duhet shtuar se dy nga këto universitete janë mbyllur, që në vitin 2014, Ilyria dhe Justicia, kështu që mungesa e veprimtarisë akademike dhe mosangazhimi në to i pedagogëve të jashtëm është fakt i njohur botërisht.
- Lidhur me pagesat nga Universiteti Polis dhe Mesdhetar për angazhimet në 2017 dhe 2018, dokumentacion justifikues janë derdhjet e tyre në llogarinë bankare, përkatësisht nga llogaritë bankare të Universiteti Polis dhe Qendra Mesdheu. Asnjë nga këto Universitete nuk ka kryer pagesa në "cash". ILDKPI gjatë kontrollit i ka disponuar statement dhe informacionet nga Raiffeissen Bank për këto pagesa për vitet 2017 dhe 2018. Ndërkohë, si subjekt kontrolli janë dorëzuar statement të bankave për vitet 2017 -2018. Gjithsesi, bashkëngjitur shpjegimeve janë edhe dy vërtetime të lëshuara nga Universiteti POLIS dhe Universiteti Mesdhetar.
- Mbi gjetjen e tretë ky konstatim lidhet me veprimtarinë dhe llojin e punësimit të bashkëshortit, i cili ka punuar si agjent shitjesh në Aeroport për llogari të shoqërisë "A.....", kjo është e vërtetuar nga librezja e punës bashkëlidhur.
- Ndërsa transaksionet në vlerën 9770 euro, janë shitje biletash nga bashkëshorti për llogari të punëdhënësit të tij në aeroport. Me këtë shumë nuk është kredituar bashkëshorti, por është kredituar kompania ku punonte, "A....." (përfaqësues dhe agjent shitjesh për shoqërinë A.A.). Kjo rezulton shumë lehtë dhe thjeshtë nga informacioni i dhënë nga banka, ku sipas transaksioneve të referuara, lexohet qartë që janë *"derdhje për shitje biletash/ cash deposit"*

A. A. Rinas", pra bashkëshorti ka derdhur shumë e biletave të shitura në cash, në periudha të caktuara kohore mars 2017-korrik 2018. Kjo shifër nuk gjendet në llogarinë personale të pagës së bashkëshortit, por në llogarinë e shoqërisë ku punonte, fakt lehtësisht i provueshëm nga vetë detajet përshkruese të transfertave. Bashkëlidhur gjenden edhe mandatet që i përkasin 6 transfertave për këtë shifër, në numrin e llogarisë bankare tek Intesa San Paolo, nr. 20074835312, të punëdhënësit të bashkëshortit. Po ashtu edhe statement të Bankës Intesa San Paolo, për llogarinë personale të bashkëshortit në euro, që nga janar 2017 - korrik 2018, që vërteton se nuk ka kredituar asnjë lloj vlere në euro.

47. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidatja Elsa Toska në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI dhe mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare duke ardhur në përfundimet e tij të sipërcituara, në raport edhe me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi, sikurse edhe shpjegimet dhe dokumentacionin shtesë si më sipër të paraqitur nga kandidatja Elsa Toska.

48. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshillit i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padëklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklaratimet e bëra nga kandidatja Elsa Toska pranë ILDKPKI në *Deklaratën e e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

49. ILDKPKI në përfundimet e raportit të kontrollit për kandidaten Elsa Toska është shprehur vetëm se (a) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor. Ndërkohë, po aty konkludohet se (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë dhe (ç) nuk ka kryer deklarim të rremë.

50. ILDKPKI përfundimin lidhur me kandidaten Elsa Toska se "a) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor.", e mbështet në tre gjetje të kontrollit të pasurisë dhe interesave private të saj, që i atribuohen periudhës 2017-2019, pra pas asaj të procesit të rivlerësimit kalimtar. *Së pari*, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara në Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për institucionet e sistemit të drejtësisë, si pedagoge e jashtme për periudhën 2017 - 2018, në Universitetin Polis, Luarasi, Justicia, Ilyria dhe Universiteti Mesdhetar. *Së dyti*, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara në Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për institucionet e sistemit të drejtësisë, si pedagoge e jashtme për periudhën 2017 - 2018, në Universitetin Polis, Luarasi, Justicia, Ilyria dhe Universiteti Mesdhetar. *Së treti*, Janë të paqarta transaksionet e konfirmuara nga DPPP në shumë rreth 9.770 euro, si dhe mungon dokumentacioni justifikues lidhur me përfitimin e tyre.

51. Po kështu, Këshilli vëren se, në procedurën e ndjekur nga ILDKPKI për ushtrimin e kompetencave të kontrollit të pasurisë nuk ka pasur ndonjë njoftim drejtuar kandidatës Elsa Toska për të dhënë shpjegime a sqarime mbi gjetjet paraprake të kontrollit sikurse janë cituar më sipër. Nga ana tjetër, në zbatim të nenit 218 pika 2 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikës 68 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Këshilli ka njoftuar kandidaten Elsa Toska për rezultatet e kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI, duke i vënë në dispozicion edhe të gjithë dokumentacionin e kontrollit të ushtruar, si edhe i ka kërkuar kësaj kandidateje që, nëse vlerëson, të paraqesë

pranë Këshillit shpjegimet e saj me gjetjet dhe përfundimet e raportit të kontrollit të ILDKPKI, duke bashkëlidhur, sipas vlerësimit të saj, edhe dokumentacion shtesë mbështetës për shpjegimet e paraqitura.

52. Kandidatja Elsa Toska ka paraqitur shpjegime me shkrim dhe disa dokumente shtesë mbështetës nëpërmjet të cilave parashtron motivet përkatëse për të treguar se deklarimi i pasurisë ka qenë i saktë dhe në përputhje me ligjin, sikurse tregohen në pikën 46 më sipër të këtij Vendimi.

53. Nga shqyrtimi në tërësi i raportit të kontrollit të ILDKPKI dhe dokumentacionit bashkëlidhur, si edhe shpjegimeve të paraqitura nga kandidatja Elsa Toska me dokumentacion shtesë mbështetës, Këshilli vlerëson se, në zbatim të drejtë të ligjit, nuk jemi përpara rastit kur mund të konkludohet që deklarimi i pasurisë nuk është i saktë në përputhje me ligjin, sikurse edhe nuk jemi përpara rastit kur ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor bashkëlidhur deklarimit të pasurisë.

54. Këshilli vëren se, sikurse rezulton qartë nga përmbajtja e Deklarimit të Pasurisë, me të drejtë kandidatja Elsa Toska parashtron që, për Universitetet Justicia, Ilyria dhe Luarasi, deklarimi nuk i referohet thjesht dhe vetëm viteve 2017 dhe 2018, as edhe vetëm deklarimeve periodike vjetore për këto dy vite. Përkundrazi, rezulton që shprehja aty "*shih formularin e vetingut, DPV ndër vite*" do të kuptohet se është deklaruar në total shuma e të ardhurave të realizuara nga mësimdhënia në këto universitete për të gjitha periudhat në të kaluarën, pa iu referuar vetëm viteve 2017 dhe 2018, pra, për të gjitha periudhat, jo vetëm pas por edhe përpara atyre të verifikuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Duke mos pasur veprimtari, për mësimdhënien në këto universitete në vitet 2017 dhe 2018, kandidatja Elsa Toska nuk ka bërë deklarime të ardhurash në deklaratat përkatëse periodike vjetore të pasurisë. Aq më tepër, vlen të evidentohet se universitetet Ilyria dhe Justicia janë mbyllur qysh në vitin 2014. Për rrjedhojë, në lidhje me këto gjetje të evidentuara nga ILDKPKI, pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit dhe pas procedurave ezauruese të ndjekura për verifikimin e pasurisë edhe nga vetë ky Këshill, arrihet në përfundimin se, sipas gjendjes së faktit dhe ligjit të zbatueshëm, nuk ka pasaktësi në deklarimin e pasurisë dhe as mospërputhje me deklaratat që bëhen në kuadër të deklarimit periodik vjetor të pasurisë.

55. Gjithashtu, ndryshe nga gjetja përkatëse e evidentuar nga ILDKPKI, për të njëjtat motive të ligjit të zbatueshëm dhe rrethanave të faktit, nga shqyrtimi i vetë përmbajtjes së Deklarimit të Pasurisë dhe dokumentacionit bankar që kandidatja Elsa Toska i ka bashkëlidhur kësaj Deklarate, Këshillit i rezulton e qartë se janë të deklaruara në të njëjtën mënyrë si në rastet e tjera, edhe të ardhurat nga Universitetet Polis dhe ai Mesdhetar. Përveçse aty, veprimtaria e mësimdhënies dhe saktësia e vlerave të deklaruara konfirmohen edhe nga vërtetimet zyrtare lëshuar nga këto dy Universitete që kandidatja Elsa Toska i ka bashkëlidhur shpjegimeve të paraqitura prej saj pranë Këshillit. Për rrjedhojë, nga Këshilli arrihet në përfundimin se, sipas gjendjes së faktit dhe ligjit të zbatueshëm, edhe në këtë rast nuk ka pasaktësi në deklarimin e pasurisë.

56. Së fundi, lidhur me gjetjen tjetër të ILDKPKI se "*Janë të paqarta transaksionet e konfirmuara nga DPPP në shumën rreth 9.770 euro, si dhe mungon dokumentacioni justifikues lidhur me përfitimin e tyre*". Këshilli vlerëson se ILDKPKI ka arritur vetëm deri në një vlerësim paraprak që, sipas çmimit të tyre, ka rezultuar në kushtet të paqartësisë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatja Elsa Toska.

57. Këshilli konstaton se, në vijim të deklarimeve të bëra dhe dokumentacionit të paraqitur pranë ILDKPKI, kandidatja Elsa Toska në shpjegimet e saj parashtron se transaksionet në shumën 9.770 euro, janë shitje biletash nga bashkëshorti për llogari të punëdhënësit të tij në aeroport. Me këtë shumë, nuk është kredituar bashkëshorti, por është kredituar kompania ku punonte, pra subjekti A..... (subjekt përfaqësues dhe agjent shitjesh për A.A.). Bashkëlidhur shpjegimeve, gjenden edhe dokumentet përkatëse bankare që tregojnë vlerat e transaktuara, natyrën e tyre dhe subjektin përfitues i këtyre vlerave financiare.

58. Këshilli vlerëson se, sikurse rezultojnë qartë nga përmbajtja e Deklarimit të Pasurisë dhe dokumentet bankare bashkëlidhur, shpjegimet e paraqitura nga kandidatja Elsa Toska pranë Këshillit dhe dokumentet që i janë bashkëlidhur, me të drejtë kjo kandidate parashtron që vlerat financiare të sipërcituara përbëjnë vlerën në total të lëvizjeve në llogari bankare, nëpërmjet të cilave, bashkëshorti i kandidates, në cilësinë e punëmarrësit të subjektit A....., ka kaluar në llogarinë e këtij subjekti (përfaqësues dhe agjent shitjesh për A.A.), shumën që rezultojnë nga shitja e biletave për llogari të kësaj shoqërie të transportit ajror. Pra, nuk kemi të bëjmë me veprimtari dhe veprime të bashkëshortit të kandidates Elsa Toska që tregojnë krijim të ardhurash personale, por për kryerjen e detyrave të tij në kuadër të marrëdhënies së punës me atë subjekt.

59. Dokumentet bankare, të gjitha transferata të kryera nëpërmjet Bankës Intesa SanPaolo, për periudhën mars 2017- korrik 2018, vërtetojnë që këto vlera financiare nuk janë lëvizur nga apo drejt e në llogari personale dhe as nuk kanë ardhur nga fonde personale të ardhurash, por janë derdhur në numrin e llogarisë së punëdhënësit A..... Edhe përshkrimi në dokumentet bankare qartazi tregon se bëhet fjalë për "*derdhje për shitje biletash/ cash deposit A. A. Rinas*".

60. Për rrjedhojë, Këshilli vjen në përfundimin se vetë natyra e këtyre transaksioneve bankare dhe vlerat përkatëse vërtetojnë se qartazi bëhet fjalë për vlera financiare të punëdhënësit të bashkëshortit të kandidates, të cilat, po në rrugë bankare janë të destinuar për subjektin A.A., pra nuk përbëjnë të ardhura personale të tij dhe në këtë mënyrë nuk jemi përpara shkeljes së ndonjë detyrimi ligjor për të deklaruar të ardhurat personale.

61. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës "dh" të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Elsa Toska ka "*kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij*". Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidate nuk rezultojnë të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

62. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidatja Elsa Toska ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*", të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

63. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1134/209 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar, duke ardhur në përfundimin se "*Subjekti deklarues Elsa Betim Toska (Dobjani/Dervishi) kandidate për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, nuk përfshihet në përcaktimet e nenit 2 të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,emërohen ose ushtrojnë funksione publike"*.

64. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Elsa Toska, krahas plotësimit të saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja "ç" e nenit 7/a të

ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati “ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;”. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidate nuk rezulton të jetë në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

65. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidatja Elsa Toska ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

66. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.551/1 prot., datë 03.05.2019 ka dërguar vendimin nr.271 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar, duke ardhur përfundimet se edhe për zonjën Elsa Betim Toska, “nga verifikimet e kryera deri tani nuk figurojnë të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” ”.

67. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Elsa Toska, krahas plotësisimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidate nuk rezulton të jetë në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

68. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidatja Elsa Toska “ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

69. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr.680/1 prot., datë 15.05.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar për verifikimin e rastit të treguar në pikën 69 më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Elsa Toska “nuk figuron e evidentuar për veprimtari kriminale.”.

70. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.1545 prot., datë 10.06.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara në pikën 69 më sipër, nga ku rezulton se “nuk disponohen materiale implikuese ose kompromentuese për integritetin e figurës së znj.Elsa Betim Toska.”.

71. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Elsa Toska nuk rezulton të jetë në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

72. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidatja Elsa Toska në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kjo kandidatë ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të saj.

73. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja Elsa Toska ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1996- 2000 si “Juriste”, në Fakultetin e Drejtësisë së Universiteti i Tiranës. Në zbatim të ligjit nr.80/2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidatja Elsa Toska nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

74. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetimit të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidatës, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Elsa Toska ka ushtruar veprimtari profesionale si :

- a) Ndihmëskomisionere pranë Avokatit të Popullit, periudha Shtator 2000 - Shkurt 2006;
- b) Avokate, pranë “Boga & Associates & KPMG”, periudha Korrik 2006 - Mars 2007;
- c) Këshilltare Ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, periudha Prill 2007- Aktualisht.
- ç) Lektore e jashtme dhe eksperte në Shkollën e Magjistraturës, Shkollën e Administratës Publike, Shkollën e Avokatisë, Fakultetet e Drejtësisë, Ekonomik dhe ai Shkencave Sociale në universitet publike, Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Mesdhetar të Tiranës, Universitetin Polis, Universitetin Justicia, Universitetin Ilyria dhe Universitetin Luarasi.

75. Bazuar në të dhënat e cituara në pikën 75 më sipër, Këshilli konstaton se kandidatja Elsa Toska ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

76. Kështu, kandidatja Elsa Toska, në kohën e kandidimit (shkurt 2018), ka ushtruar 10 vjet dhe 10 muaj detyrën e këshilltares ligjore të Gjykatës Kushtetuese, 5 vjet dhe 5 muaj detyrën e ndihmëskomisioneres pranë Avokatit të Popullit dhe 8 muaj profesionin e avokates. Në mbledhje të këtyre përvojave profesionale, rezulton se kjo candidate ka së paku 17 vjet dhe 1 muaj veprimtari profesionale ndërmjet atyre që parashikohen shprehimisht nga Kushtetuta dhe ligji.

77. Ndërkohë që lidhur me ushtrimin e përvojave profesionale të këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese dhe asaj të avokatisë Këshilli vlerësoi se ato bëjnë pjesë në llojet e veprimtarisë që përfshihen në ato të përcaktuara në nenin 125 të Kushtetutës, nga ana tjetër, për ushtrimin e funksionit të ndihmëskomisioneres së Avokatit të Popullit, ky Këshill vendosi në bisedim nëse jemi përpara një veprimtarie profesionale që përfshihet ose jo në atë të “nëpunësit të nivelit të lartë në administratën publike” (neni 125/4 i Kushtetutës) dhe “jurist i nivelit të lartë” (neni 7/a i ligjit nr.8577/2000).

78. Sipas pikës 4 të nenit 125 të Kushtetutës, kandidati që kërkon të zgjidhet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ndërmjet të tjerave, duhet të plotësojë kushtet që lidhen me (a)15 vjet përvojë pune dhe (b) ushtrimin e kësaj përvoje si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor të së drejtës, nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike.

79. Nga ana tjetër, pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës ka njohur rezervën ligjore absolute të Kuvendit për të rregulluar me ligj “Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”. Kështu, mbi këtë delegim kushtetues të nenit 125 të Kushtetutës, ligjvënësi, në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 (i shtuar me ligjin nr.99/2016), të titulluar “Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”, ka përcaktuar kritere të tjera ligjore, të cilat, natyrshëm, nuk mund të gjenden shprehimisht në Kushtetutë, sepse përndryshe do të ishte i pakuptimtë vetë urdhërimi kushtetues. Nga kjo pikëpamje, kriteret e tjera ligjore, që gjenden të parashikuara në nenin 7/a të ligjit 99/2016 nuk mund të mos respektohen.

80. Është e njohur për drejtësinë kushtetuese parimi i prezumimit ligjor të kushtetutshmërisë së normës konkrete, derisa shpallja e antikushtetutshmërisë së saj të bëhet nga një vendim përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese. Ky parim e ka bazën edhe në argumentin tjetër që lidhet me prezumimin e racionalitetit të ligjvënësit në ushtrimin e pushtetit të tij. Qëllimi i ligjvënësit nuk është arritja e rezultateve absurde, por shmangia e paqartësive dhe e kontradiksionit në ligj, me qëllim përputhjen e tyre me parimet dhe standardet kushtetuese. Në vendimin nr. 16, datë 25.07.2008, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së kufizimit të të drejtave e lirive individuale, kjo Gjykatë nisat nga prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjit me Kushtetutën. Kjo do të thotë, se Gjykata nuk ka autoritet të kontrollojë synimet dhe drejtësinë e zgjidhjeve të zbatuara nga ana e ligjvënësit. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara nuk shkelin normat dhe vlerat kushtetuese.

81. Këshilli vlerëson të evidentojë se, konkretisht, në nenin 7/a të ligjit 99/2016, ashtu sikurse edhe në nenin 240 të ligjit 115/2016, gjenden të sanksionuara kritere të tjera ligjore, mbi të cilat do të kryhet verifikimi i kandidaturave, por edhe renditja e kandidatëve, në bazë të meritave të tyre profesionale, morale, organizative, drejtuese dhe menaxheriale. Duke ju referuar parashikimeve ligjore që gjenden në këto dispozita, konstatohet lehtësisht se ligjvënësi, brenda pushtetit të tij të deleguar nga Kushtetuta, ka renditur shumë kritere të tjera, referuar kushteve bazë që Kushtetuta ka parashikuar për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese.

82. Këshilli vëren se, për të qartësuar kuptimin kushtetues të frazës “*nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike*” (neni 125/4 i Kushtetutës), ligjvënësi ka parashikuar në nenin 7/a të ligjit 99/2016, ndërmjet të tjerave, plotësimin e kriterit ligjor “*jurist i nivelit të lartë në administratën publike*”. Këto dy formulime duket sikur kundërshtojnë njëri tjetrin. Por, është vendi të evidentohet se Kushtetuta dhe ligji nuk kanë pasur për qëllim as të konfundojnë kuptimin që i duhet dhënë, por as edhe të keqzatojnë përdorimin e këtij termi.

83. Kështu, qëllimi primar që kërkon kriteri i prurjeve nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve, profesorëve dhe nëpunësve të administratës është veprimtaria e spikatur e tyre në fushën e së drejtës, në veçanti, atë kushtetuese. Pikërisht nëpërmjet përzgjedhjes dhe emërimit të kandidatave nga disa institucione kushtetuese shmanget edhe politizimi, ndërkohë që nëpërmjet ardhjes së këtyre gjyqtarëve nga fusha të ndryshme të së drejtës garantohet edhe një përbërje e Gjykatës Kushtetuese me vlera të posaçme profesionale dhe ekuilibër kushtetues.

84. Pikërisht rritja e cilësisë së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese është në të vërtetë qëllimi kryesor i kushtetutbërësit dhe jo pozicioni i tyre “i lartë” në nivelin administrativ. Togfjalëshi kushtetues “*nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike*” (neni 125/4), nuk duhet konfunduar dhe as duhet njëhsuar me togfjalëshin “*nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese*”, që parashikohet në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”.

85. Ligji nr. 152/2013 rregullon marrëdhënien juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil, si dhe përcakton rregullat për administrimin e shërbimit civil. Prandaj edhe neni 19 i tij, i titulluar “*Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil*”, bën klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit, duke pasur në referencë pikërisht përkufizimin e ligjit “*Nëpunës civilë i kategorisë së lartë drejtuese*” dhe aspak kuptimin dhe përmbajtjen e shprehjes kushtetuese të nenit 125/4 “*nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike*”. Në këtë të fundit nuk përfshihen nëpunësit civil sipas klasifikimit që bën neni 19 i ligjit 152/2013. Qëllimi i normës kushtetuese është evidentimi i atyre nëpunësve të administratës publike që dëshmojnë për një nivel të lartë të veprimtarisë së spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës, dhe jo nivel të lartë në emërtesën e strukturës administrative.

86. Për këtë arsye, në ligjin 99/2016, neni 7/a, pika 2, parashikohet se kandidati duhet, ndërmjet të tjerave, “*të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike*”. Ky term është tërësisht në përputhje me qëllimin e kushtetutbërësit për rritjen e cilësisë së kësaj gjykate dhe qëndrueshmërinë e saj përballë presioneve politike të çdo lloji. Në të njëjtën logjikë kushtetuese, jo pa qëllim është përdorur nga neni 136/3 i Kushtetutës shprehja “*jurist i nivelit të lartë në administratën publike*” edhe kur ka parashikuar kriteret për gjyqtar të Gjykatës së Lartë që vijnë nga radhët e jogjyqtarëve.

87. Për këto arsye, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se formulimi “*jurist i nivelit të lartë në administratën publike*”, që ka përdorur ligjvënësi në nenin 7/a, pika 2 të ligjit 99/2016, është në të njëjtën synim dhe orientim që ka norma kushtetuese për përfshirjen në Gjykatën Kushtetuese të atyre juristëve të administratës publike, të cilët kanë treguar një nivel të lartë të profesionalizmit dhe që do i shërbejnë cilësisë së vendimmarrjes së Gjykatës, si autoriteti më i lartë në Republikën e Shqipërisë, e cila bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese.

88. Prandaj Këshilli vjen në përfundimin se, Kushtetuta nuk ka si qëllim që në Gjykatën Kushtetuese të përfshihen ata jurist që vlerësohen më tepër për nivelin e lartë të drejtimit administrativ, sesa ata juristë që spikasin për veprimtarinë e tyre profesionale, të evidentuar veçanërisht në të drejtën kushtetuese dhe të drejtat e njeriut. Pikërisht, për të evidentuar spikatjen e kandidatit me vlera të larta profesionale në fushën e drejtësisë kushtetuese, nuk mund të shërbejë klasifikimi i tij në pozicionet e shërbimit civil sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit, por vetëm aftësia dhe performanca në disiplinat e caktuara të së drejtës.

89. Mbështetur mbi këtë interpretim dhe zbatim të drejtë të Kushtetutës dhe ligjeve të miratuara në pajtime të, Këshilli vlerëson se, në çështjen konkrete, kandidatja Elsa Toska, për një periudhë mbi 5 vjeçare ka ushtruar veprimtari nga ato që përfshihen në atë të *“juristit të nivelit të lartë në administratën publike”*, nisur nga natyra dhe lloji i detyrës dhe i veprimtarisë profesionale që ka ushtruar, trajtimi në këtë veprimtari dhe në përmbushjen e detyrës të çështjeve që lidhen me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut e lirive themelore, respektimin e të drejtave dhe interesave kushtetues e ligjore të individëve përkundrejt sjelljes dhe veprimeve abuzive a të pajustificuara ligjërisht të administratës shtetërore etj., aq më tepër që kjo veprimtari profesionale, sistematikisht dhe për një periudhë të gjatë kohore është ushtruar pranë Avokatit të Popullit, një institucion i parashikuar posaçërisht nga Kushtetuta për të mbrojtur *“të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”* (neni 60 i Kushtetutës).

90. Këshilli vëren se kandidatja Elsa Toska ka ushtruar detyrën e “ndihmëskomisioneres” pranë institucionit kushtetues të Avokatit të Popullit. Nisur nga ligji nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit” dhe Rregullorja e Brendshme e Punës, organizimi i brendshëm i Avokatit të Popullit, jo vetëm në periudhën kur kandidatja ka ushtruar detyrën pranë këtij institucioni por edhe aktualisht, për ushtrimin e kompetencave kushtetuese mbështetet në tre nivele hierarkie dhe funksionesh: Avokati i Popullit, Komisioneri dhe Ndhimëskomisioneri. Sipas këtij Ligji dhe Rregulloreve të Brendshme të çdo periudhe, rezulton se ndihmës komisionerët janë funksionarë të përzgjedhur për cilësitë e tyre profesionale dhe për të ushtruar detyra profesionale thelbësore për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit.

91. Ndhimëskomisioneri është i ngarkuar që, për shkak të njohurive profesionale, specializimit dhe ekspertizës që zotëron, të trajtojë në të gjithë aspektet, nga momenti i paraqitjes së çështjes dhe deri në përfundimin e saj. Ndërmjet të tjerave, përgjegjësi dhe detyrë ligjore dhe tërësisht me natyrë profesionale e ndihmëskomisionerit është verifikimi i rastit në fakt dhe në terren, identifikimi dhe studimi i ligjit të zbatueshëm, praktikës gjyqësore, përfshirë edhe së drejtës e praktikës gjyqësore ndërkombëtare, përgatitja e informacioneve, korrespondencave, projektdokumenteve dhe projektraporteveve që duhet të shqyrtojë dhe miratojë komisioneri dhe Avokati i Popullit, sikurse edhe i dokumenteve të tjerë të rëndësishëm të institucionit të Avokatit të Popullit, përfshirë edhe përgatitje të studimeve, publikimeve apo edhe pjesëve të raportit vjetor të këtij institucioni që lidhen me fushën specifike të veprimtarisë së seksionit ku ndihmëskomisioneri ushtron detyrën e tij. Në ushtrimin e detyrës, ndihmëskomisioneri përgjigjet dhe ngarkohet me detyrat përkatëse nga Komisioneri ose në mënyrë direkte nga Avokati i Popullit.

92. Këshilli vlerëson se, sa më sipër, është vetëm një trajtim shumë i përmbledhur për të treguar natyrën dhe llojin e veprimtarisë profesionale, si edhe rëndësinë e posaçme të detyrës së ndihmëskomisionerit në institucionin kushtetues të Avokatit të Popullit, pa qenë i nevojshëm që, për qëllimet e arsytimit të këtij vendimi, të citohen dhe vendosen në këtë vendim

dispozitat e shumta dhe të hollësishme të Rregulloreve të Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm të kohës kur kandidatja Elsa Toska ka ushtruar detyrën e në vijim, por edhe në përmbajtjen aktuale të kësaj Rregulloreje dhe organizimin aktual të institucionit të Avokatit të Popullit.

93. Sipas ligjit dhe organizimit të kohës, në periudhën shtator 2000 deri në shkurt 2006, kandidatja Elsa Toska ka ushtruar detyrën e ndihmëskomisioneres pranë Avokatit të Popullit në *Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve, që vepron në për llogari të tyre*, si edhe në *Seksionin e përgjithshëm për trajtimin e çështjeve jashtë fushave të mësipërme, për bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe për studimet e veprimtarisë në fushën e të drejtave dhe të lirive të njeriut*.

94. Nisur nga arsyetimet e parashtruara më sipër në këtë vendim, lidhur me interpretimin dhe zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjeve të nxjerra në pajtim me të për sa i përket kushteve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, dispozitave kushtetuese dhe ligjore për institucionin e Avokatit të Popullit, rregullave të brendshme të organizimit dhe funksionimit të këtij institucioni, rëndësisë, natyrës dhe llojit të veprimtarive që ushtron Avokati i Popullit, si edhe natyrës dhe llojit të detyrave profesionale që i ngarkohen të ushtrojë ndihmëskomisionerit pranë këtij institucioni kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se ushtrimi i këtyre detyrave nga ndihmëskomisioneri i Avokatit të Popullit përfshihet në veprimtarinë e “juristit të nivelit të lartë në administratën publike” të parashikuar nga neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000.

95. Në përfundim të analizës së veprimtarive profesionale të ushtruara Këshilli vëren se, kandidatja Elsa Toska, në kohën e kandidimit (shkurt 2018), ka ushtruar 10 vjet dhe 10 muaj detyrën e këshilltares ligjore të Gjykatës Kushtetuese, 5 vjet dhe 5 muaj detyrën e ndihmëskomisioneres pranë Avokatit të Popullit dhe 8 muaj profesionin e avokates. Në mbledhje të këtyre përvojave profesionale, rezulton se kjo kandidatë ka së paku 17 vjet dhe 1 muaj veprimtari profesionale ndërmjet atyre që parashikohen shprehimisht nga Kushtetuta dhe ligji. Prandaj, Këshilli vjen në përfundimin që kandidatja Elsa Toska ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

96. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, sikurse parashtrohet në pikën 75 më sipër, nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidatës për veprimtaritë e ushtruara prej saj, Këshilli konstaton se kandidatja Elsa Toska nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike. Për rrjedhojë, kjo kandidatë nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

97. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidatës për veprimtaritë e ushtruara prej saj, si edhe shkresat me përgjigje të dërguara sipas kërkesës së Këshillit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga parti politike, Këshilli konstaton se kandidatja Elsa Toska nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike. Për rrjedhojë, kandidatja Elsa Toska nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

98. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatja të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, informacioni i dërguar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr.144/1 prot, datë 23.04.2019, që janë të administruara në dosjen e kandidatës, Këshillit i rezulton se kandidatja Elsa Toska nuk ka marrë dhe nuk ka asnjë masë disiplinore të regjistruar që nga fillimi i marrëdhënieve të punës. Për rrjedhojë, kandidatja Elsa Toska nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

99. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidatës, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatës Elsa Toska, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “ Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatës Elsa Toska, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Elsa Toska.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI



MENDIM PAKICE

Unë anetarja e KED **Margarita Buhali** kam votuar kundër vendimit të marrë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me nr.103 dt.30.07.2019 për lejimin e kandidimit të znj.Elsa Toska në vendin vakand të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të shpallur nga presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

Për mendimin tim znj.Elsa Toska nuk plotëson kushtet ligjore të kandidimit sipas nenit 237 dhe 7/a të ligjit nr.8577/2000, nenin 147 të Kushtetutës dhe **për këtë shkak duhet të vendosej ndalimi i kandidimit**. Në zbatim të nenit 47 të vendimit nr.4/2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi paraqesin mendimin në pakicë kundër vendimit nr.103 dt.30.07.2019.

Sipas të dhënave të vjetërsisë në punë të kandidatës rezulton se ajo ka mbajtur detyrën e ndihmësKomisionere pranë Avokatit të Popullit, për periudhën Shtator 2000 - Shkurt 2006. Vetëm në vitin 2005 ajo ka filluar të ushtrojë gjithashtu detyrën si pedagoge e jashtme. Cështja që shtrohet për diskutim është nëse nëse kandidatja e plotëson kushtin ligjor të 15 vjet përvojë pune të përcaktuar si në Kushtetutë dhe në ligjin e posacëm për gjykatën Kushtetuese.

a-Kështu neni 125/4 i Kushtetutës parashikon se; *Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*

b- Ligji nr.8577 dt.10.02.2000 neni 7/a parashikon se; *Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere: a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*

Në të dy këto dispozita rezulton se kandidati duhet të ketë jo më pak se 15 përvojë pune në këtë profesione: **gjyqtar, prokuror, avokate, profesor ose lektor i të drejtës dhe nëpunës (jurist) i nivelit të lartë në administratën publike**. Gjithë diskutimi për kandidaten është nëse pozicioni i punës që ajo ka mbajtur në periudhën 2000-2006 si ndihmëskomisionere konsiderohet nëpunës ose jurist i nivelit të lartë në administratën publike. Në dy ligjet bazë të reformës në drejtësi nr.84/2016 dhe ai nr.96/2016 ose në ligjin e posacëm për gjykatën kushtetuese nuk jepet asnjë përkufizim për togfjalëshin “nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike”. I vetmi ligj, që jep përkufizimin per ndarjen e kategorive të nëpunësve është ai “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë” nr.152/2013 në fuqi aktualisht dhe ai nr.8549/1999 në fuqi në kohën, kur kandidatja ka ushtruar detyrën e ndihmëskomisionerit. Gjithashtu duke qënë se ajo ka mbajtur këtë detyrë në administratën e Avokatit të Popullit analizohet edhe ligji nr. 8454/1999 “Për avokatin e popullit”. Kuadri ligjor për përcaktimin e pozicionit të punës së kandidatës përcaktohet nga dispozitat si më poshtë;

Ligji nr.8454/1999 në fuqi në kohën kur është ushtruar detyra e ndihmëskomisioneres nga kandidatja.

Neni 31

Struktura

Zyra e Avokatit të Popullit ndahet në 3 seksione të specializuara, në krye të të cilave vendosen komisionarët.

Neni 33

Zgjedhja e komisionarëve dhe paga e tyre

Komisionarët zgjidhen ndër juristët më të shquar, për një mandat 3-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Zgjedhja e tyre bëhet nga Kuvendi me propozimin e Avokatit të Popullit. Për zgjedhjen e komisionarëve zbatohen kushtet e parashikuara në nenin 3 dhe në nenin 10 të këtij ligji. Paga e komisionarëve është sa dy të tretat e pagës së Avokatit të Popullit.

Neni 35 ndryshuar me ligjin nr. 8600 dt.10.04.2000

Personeli i zyrës së Avokatit të Popullit

Personeli i zyrës së Avokatit të Popullit bën pjesë në shërbimin civil të Republikës së Shqipërisë.

Struktura dhe organika e zyrës së Avokatit të Popullit caktohet nga Avokati i Popullit."

Ligji nr.8549/1999

"Nëpunësit civilë" në kuptim të këtij ligji janë ata nëpunës të institucioneve të administratës publike të nivelit qendror apo vendor, të cilët ushtrojnë autoritetin publik në detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse apo ekzekutuese, përcaktuar sipas nenit 11 të këtij ligji.

Neni 11

Klasat

1. Klasat e nëpunësve civil janë këto:

a) Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues.

b) Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues.

c) Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues.

ç) Nëpunës civilë të nivelit ekzekutues.

2. Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues konsiderohen këto pozicione:

a) Sekretar i përgjithshëm.

b) Drejtor departamenti.

c) Drejtor drejtorie të përgjithshme.

ç) **Pozicionet e barasvlershme me tre të parat në institucionet e administratës publike qendrore apo vendore.**

3. Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues konsiderohen këto pozicione:

a) **Drejtor drejtorie.**

b) **Pozicionet e barasvlershme me to.**

4. Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues konsiderohen këto pozicione:

a) Shef sektori.

b) Shef zyre.

c) Pozicionet e barasvlershme me to.

5. Nëpunës civilë të nivelit ekzekutues konsiderohen specialistët.

6. Këshilli i Ministrave dhe institucionet e pavarura bëjnë klasifikime ose caktojnë nivele të ndryshme brenda secilës klasë, përkatësisht në institucionet e administratës qendrore ose në institucionet e pavarura përkatëse.

Neni 13 -Pranimi

1. **Pranimi në shërbimin civil kryhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në meritat.**

2. Në administratën qendrore shpallja e konkurrimit bëhet nga Departamenti i Administratës Publike, me kërkesën e institucionit përkatës. Në institucionet e pavarura, shpallja bëhet nga departamentet e personelit.

3. Shpallja botohet në dy gazetata me qarkullim më të madh të paktën 30 ditë para datës së caktuar për konkurrim.

4. Shpallja për konkurrim përmban një listë të kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët dhe të fushave në të cilat do të zhvillohet konkurrimi, të përcaktuara nga Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me institucionin propozues të administratës qendrore dhe nga departamentet e personelit për institucionet e pavarura.

5. Konkurrimi zhvillohet në tri faza:

a) **Në fazën e parë bëhet përzgjedhja e kandidatëve për t'iu nënshtruar testimit dhe konsiston në verifikimin nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.** Vetëm kandidatët që plotësojnë këto kërkesa do të pranohen për t'iu nënshtruar fazës së testimit. Kjo fazë zhvillohet nga Departamenti i Administratës Publike për institucionet e administratës qendrore dhe nga departamentet e personelit për institucionet e pavarura.

b) **Në fazën e dytë zhvillohet testimi.** Për zhvillimin e kësaj faze, Departamenti i Administratës Publike për institucionet e administratës qendrore dhe departamentet e personelit në institucionet e pavarura, krijojnë komitete të veçanta ad-hoc. Këto komitete përbëhen prej pesë anëtarësh: një përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike për institucionet qendrore ose një përfaqësues i Departamentit të Personelit për institucionet e pavarura; dy përfaqësues të institucionit të administratës publike qendrore apo vendore që kanë kërkuar plotësimin e vendit të lirë; dy profesorë nga fakulteti apo katedra sipas fushës në të cilën do të zhvillohet testimi ose dy specialistë të njohur nga fusha përkatëse. Komiteti ad-hoc do të hartojë një listë me tre kandidatët me rezultatet më të larta, duke u bazuar kryesisht në rezultatet e testeve, por edhe në kualifikimet, përvojën profesionale, publikimet shkencore dhe aftësitë e veçanta të kandidatëve. Rezultatet e testeve do të përbëjnë 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, ndërsa kualifikimet, përvoja profesionale, publikimet shkencore dhe aftësitë e veçanta të kandidatëve do të përbëjnë 30 për qind të pikëve.

c) **Në fazën e tretë bëhet vlerësimi përfundimtar i kandidatëve.** Në këtë fazë, eprori direkt nën varësinë e të cilit nëpunësi do të punojë, zgjedh një nga tre kandidatët e propozuar nga komitetet ad-hoc.

6. Ankesat për zhvillimin dhe rezultatin e konkurrimit paraqiten në Komisionin e Shërbimit Civil, brenda 30 ditëve pune nga botimi i rezultateve të konkurrimit në dy gazetat me qarkullim më të madh. Nëse një ankesë rezulton e drejtë, ankuesi do t'i propozohet institucioneve për vendin më të parë të lirë të të njëjtës kategori dhe nivel që ai ka aplikuar.

7. Marrëdhëniet juridike të nëpunësit civil fillojnë me aktin e emërimit në shërbimin civil dhe janë pa afat. Akti i emërimit firmoset nga Departamenti i Administratës Publike për institucionet e administratës qendrore dhe nga departamentet e personelit për institucionet e pavarura, pasi kalon afati për paraqitjen e ankesave, parashikuar në pikën 6 këtij neni.

Periudha e provës

1. Nëpunësi civil i nënshtrohet një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit. Gjatë kësaj periudhe ai është nën kujdesin e një nëpunësi të vjetër dhe vlerësohet nga eprori më i afërt i tij. Veprimtaritë e trajnimit të përgjithshëm dhe të veçantë janë të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove.

2. Në fund të periudhës së provës, eprori direkt vendos:

a) konfirmimin si nëpunës civil;

b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë;

c) largimin nga shërbimi civil dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm.

Neni 26

Regjistri i personelit

1. Departamenti i Administratës Publike ngarkohet me krijimin dhe administrimin e Regjistrimit Qendror të Personelit. Ky Regjistër përmban të dhënat profesionale dhe të karrierës së nëpunësve civilë.

2. Çdo institucion i administratës publike mban dosjet e personelit për nëpunësit e tij.
3. Dosjet e personelit dhe Regjistri Qendror i Personelit kanë karakter konfidencial dhe çdo nëpunës civil, ka të drejtë të njihet me informacionin në lidhje me të. Me këtë informacion mund të njihet edhe Komisioni i Shërbimit Civil, si dhe gjykatat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
4. Këshilli i Ministrave përcakton veçoritë e këtij Regjistri e të dosjeve, si dhe llojin e të dhënave që mbahen në to. Përdorimi i këtyre të dhënave bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".
5. Institucionet e pavarura mbajnë regjistrin e personelit me të njëjtat të dhëna.

Në botimin e Avokatit të popullit të vitit 2003 është përcaktuar struktura e tij organizative e cila është në formën e një skeme

STRUKTURA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Kabineti

KOMISIONERI i Seksionit të Organeve të Administratës
 KOMISIONERI i Seksionit të Shërbimeve të Veçanta
 KOMISIONERI i Seksionit të Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm
 Sektori i Financës
 Sektori i Pritjes së Popullit
 Sektori i Informatikës
 Sektori i Sekretarisë dhe Arshivës

Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë
 Sektori i Përkthimit dhe Bibliotekës
 Sektori i Përkthimit dhe Bibliotekës

Drejtorja e Personelit dhe Administratës
 Sektori i Administratës

Vendim i këshillit të ministrave nr.500 dt.18.07.2003

Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civile në zyrën e Avokatit të Popullit të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Për punonjësit e tjerë të zyrës së Avokatit të Popullit të zbatohet lidhja 11/4 "Nivelet e pagës sipas funksioneve në Këshillin e Ministrave", që i bashkëlidhet vendimit nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", i ndryshuar.

Klasa Emërtimi Paga individuale (Paga baze) Shtesa e pozicionit

1 2 3 4

Paga e grupit (PG) Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) Shtesa për kualifikim (SHK) Shtesa për pozicio(SHP)

I-a Sekretar I Përgjithshëm 9000 2% 0 111000

II-a Ndhmës komisionar kategoria e parë 9000 2% 0 90 000 II-b Ndhmës komisionar kategoria e dytë

Drejtor Drejtorie 9000 2% 0 74 000

Në raportin e OSBE për monitorimin e veprimtarisë së avokatit të popullit në periudhën e punës së kandidatës citohet se në zyrën e avokatin të popullit pranë çdo komisioneri janë nga 5 juristi sipas strukturës së vitit 2002.

Duke mbajtur në konsideratë gjithë kuadrin ligjor të sipërcituar si anëtare në pakice vlerësoj se periudha e punës së kandidatës Elsa Toska si ndihmëskomisionere nuk konsiderohet përvojë pune si nëpunëse e nivelit të lartë të Administratës publike sipas nenit 125 të Kushtetutës ose juriste e nivelit të lartë sipas nenit 7/a të ligjit “Për gjykatën kushtetuese” pasi;

a-Duke qënë se i vetmi ligj, që njih konceptin e nëpunësit të nivelit të lartë, është ai mbi “Për shërbimin civil” nr. 8549/1999 në fuqi në kohën e punësimit të kandidatës si ndihmëskomisionere atëherë është i nevojshëm referimi të ky ligj për të përcaktuar nivelin e nëpunësit, që gëzonte kandidatja. Përcaktimi i togfjalëshit jurist i nivelit të lartë në nenin 7/a të ligjit “Për gjykatën kushtetuese” nuk përjashton zbatimin e ligjit “Për shërbimin civil” pasi nivili i lartë është togfjalësh përcaktues, që gjen rregullim vetëm në ligjin “Për shërbimin civil”. Gjithashtu po në këtë ligj veç kategorisë së nëpunësve të nivelit të lartë të përcaktuar në mënyrë të shprehur sipas pozicioneve konkrete të punës, parashikohet se në kategorinë e nëpunësve të lartë përfshihet edhe nëpunës, që mbajnë pozicione të barasvlefshme me to.

Kandidatja rezulton se ka filluar punë në pozicionin e ndihmëskomisionerit në Shtator të vitit 2000, ndërkohë që ka përfunduar arsimin e lartë juridik po në vitin 2000 në muajin Korrik. Pra ajo ka filluar punë në këtë detyrë menjëherë pas përfundimit të studimeve të larta Nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidatja dhe ai i administruar nga KED nuk është verifikuar se në çfarë mënyre është emëruar kjo kandidate në këtë pozicion pune, pasi pretendohet se detyra e mbajtur prej saj konsiderohet si pjese e shërbimit civil . Gjithashtu nuk është administruar as rregjistri i kandidatës si nëpunëse civile pranë DAP nëpërmjet të cilës do të sqarohet statusi i nëpunësit civil dhe nivelin e nëpunësit, që kishte kjo kandidate në detyrën e ndihmëskomisionerit. Mungesa e këtyre të dhënave tregon se nuk është hetuar në mënyrë të plotë pranë organeve kompetente nëse kandidatja kishte statusin e nëpunësit civil, kur e kishte fituar këtë status dhe cili ishte niveli i kualifikimit, që ajo gëzonte si nëpunëse civile. Gjithashtu një rrethanë e tillë nuk është verifikuar në mënyrë të plotë as te institucioni kompetent “Avokati i Popullit”, ku ka punuar kandidateja për periudhën 2000-2006. Ky organ ka dokumentacionin e plotë për të përcaktuar nëse kandidatja e ka fituar statusin e nëpunësit civil, kur e ka fituar, nëse e ka fituar çfarë niveli nëpunësi civil konsiderohet pozicioni i punës së ndihmëskomisionerit dhe ai konkretisht i mbajtur nga kandidatja në vitet 2000-2006. Hetimi i këtij fakti pranë avokatit të popullit do të mundësonte verifikimin e kohës së fitimit të statusit të nëpunësit civil nga kandidatja dhe kategorine e nëpunësit civil që ajo gëzonte, gjë që duhet të përcaktohet nga aktet dokumentare të administruara në zyrën e personalit të institucionit ose në rregjistrat përkatës të administruar pranë DAP. Gjithashtu edhe vetë kandidatja nuk ka paraqitur akte të lëshuara nga institucionet kompetente për të provuar faktin nëse ajo e kishte përfitur statusin e nëpunësit civil, kohën dhe mënyrën si e

kishte përfituar atë dhe nivelin e nëpunësit civil, që ajo ka mbajtur në detyrën e ndihmës komisionerit. Në mungesë të këtyre akteve nuk vërtetohet se pozicioni i punës si ndihmëskomisionere i mbajtur nga kandidatja të konsiderohet nëpunës i nivelit të lartë të administratës publike.

b-Edhe në kuadër të gjithë legjislationit në fuqi në kohën e realizimit të kësaj detyre nga kandidatja rezulton se ndihmëskomisioneri nuk përfshihet në kategorinë e nëpunësve e nivelit të lartë të administratës publike, pasi në ligjin e posaçëm “Për avokatin e popullit nr.8454/1999 ky pozicion nuk citohet në mënyrë të shprehur në ligj. Ky pozicion pune rezulton të jetë përcaktuar me vendim të avokatit të popullit sipas nenit 35 të ligjit nr.8454/1999 të ndryshuar me ligjin nr.8600/2000. Në ligj përcaktohet si pozicion pune, që ndihmon avokatin e popullit në realizimin e detyrave të tij komisioneri. Si avokati i popullit dhe komisionerët zgjidhen nga rradhët e juristëve të shquar. Në këtë kushte duke qënë se pozicioni i tyre i punës parashikohet shprehimisht në ligj atëhere janë këta subjekte, që gëzojnë statusin e nëpunësve të nivelit të lartë të administratës publike. Ndihmëskomisioneri nuk ka një detyrë mirëfillte vendimmarrëse, por mbështetëse në përgatitjen e çështjeve për komisionerin. Si i tillë pozicioni i tyre është më i ulët se ai i komisionerit, duke e përfshirë atë maksimalisht në kategorinë e nëpunësve civil të nivelit të mesëm.

Sipas nenit 11/2 të ligjit nr.8549/1999 dhe vendimit të këshillit të ministrave nr.500 dt.18.07.2003 “Për strukturën dhe nivelin e pagave të personelit të zyrës së avokatit të popullit” rezulton se ndihmëskomisionerët përfshihen në pozicionin e nëpunësve civil të njëjtë me atë të drejtorëve të drejtorie, pozicion që konsiderohet nëpunës civil **i nivelit të mesëm**. Në këtë mënyrë sipas akteve ligjor dhe nënligjore të periudhës kur ka ushtruar detyrën e ndihmëskomisioneres kandidatja përcaktohet qartazi se pozicioni i punës së ndihmëskomisionerit të avokati i popullit nuk konsiderohet nëpunës i nivelit të lartë, por i nivelit të mesëm. Si rrjedhim për periudhën e punës në këtë pozicion kandidatja nuk plotëson kushtin e nëpunësit të nivelit të lartë të administratës publike sipas nenit 125 të Kushtetutës. Përcaktimi i nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 nën togfjalëshin jurist i nivelit të lartë nuk bie ndesh me Kushtetutën, pasi në ligjin “Për shërbimin civil” dhe aktet nënligjore janë të përcaktuara klasat, që gëzojnë juristët sipas pozicionit të punës që mbajë duke i kategorizuar ata në nivele për shkak të vlerës së barabartë, që i kanë dhënë me pozicione të tjera, që janë të parashikuara në mënyrë të shprehur në secilin prej niveleve të klasave të nëpunësve civil. Edhe ligji aktual “Për shërbimin civil” nr.152/2013 ose “Për avokatin e popullit” nuk përcaktojnë ndonjë nivel më të lartë kategorie për ndihmëskomisionerët sesa pozicioni i drejtorit të drejtorisë. Në të tilla kushte rezulton se për periudhën 2000-2005 kandidatja nuk ka ushtruar detyra si juriste ose nëpunëse e nivelit të lartë në administratën publike. Për këtë shkak kjo përvojë pune nuk mund të përfshihet në vjetërsinë e punës, që kërkohet sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/1999 pasi kandidatja nuk ka mbajtur asnjë prej pozicioneve të punës, që kërkohen për përvojën 15 vjeçare të vjetërsisë si kusht për kandidimin në vendin vakant të gjyqtarit të gjykatës kushtetuese.

Kushtetuta dhe ligji i posaçëm kërkojnë të plotësohet njëkohësisht dy kushte : 1-përvoja 15 vjet dhe 2- në pozicionet gjyqtar, jurist ose nëpunëse e nivelit të lartë në administratën publike, prokuror, avokat, lektor i të drejtës. Në vitet 2000-2005 kandidatja nuk ka pasur asnjë prej këtyre funksioneve. Si e tillë për këtë periudhë ajo nuk plotëson kushtet e vjetërsisë së kandidimit për anëtar të gjykatës kushtetuese, gjë që do të sillte si pasojë uljen e vjetërsisë totale të saj në pozicionet e njohura nga neni 125 i Kushtetutës nën 14 vjet përvojë pune. Si rrjedhim kandidatja nuk plotëson kushtet e vjetërsisë në punë sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit 8577/2000.

ce- Kandidatja gjithashtu nuk ka provuar sec në periudhën 2000-2005 të ketë pasur një veprimtari të spikatur në fushën e të drejtave të njëriut, duke mbajtur në konsideratë këtu përcaktimet e nenit 125 të Kushtetutës, ku qëllimi është përzgjedhja e juristëve me përvojë të dallueshme profesionale për 15 vjet. Ajo nuk ka paraqitur në KED ndonjë produkt të veçantë të punës së saj si individ komisioner në këtë periudhë, e cila ka sjellë impakte të tilla publike duke përfshirë atë në radhën e juristëve me veprimtari të spikatur. Pra edhe puna konkrete realizuar nga kandidatja në periudhën 2000-2005 nuk e evidenton atë nga rradhët e juristëve të tjerë që kanë mbajtur detyra të nepunësve civil të nivelit të mesëm në administratën publike.

Për samë sipër

Bazuar në nenin 12377 të ligjit nr.115/2016, nenin 77/a të ligjit nr.8577/2000 dhe nenin 125 të Kushtetutës

Mendimi im në pakicë lidhur me kandidimin e znj. Elsa Toska është:

Ndalimin e kandidimit të znj. Elsa Toska në vendin vakant të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

ANËTARE

Margarita BUHALI

